

# UDHA ISLAMIE

Viti XII - Nr. 3 (133), Mars, 2014

E përnuajshme Informativ - Fetare - Kulturore - Edukative

Botim i Myftinisë Shkodër

## SKENDER BRUÇAJ, KRYETARI I RI I KMSH



## SKENDER BRUÇAJ ZGJIDHET KRYETAR I RI I KMSH-SË

**K**ëshilli i Përgjithshëm i KMSH, i mbledhur më 8 mars 2014, në mbledhjen e tij të zakonshme, zgjodhi z. Skender Bruçaj si kryetarin e ri të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë.

Pas përfundimit të mandatit të Kryetarit H. Selim Muça, kandidatit për detyrën e kryetarit ishin: nënkryetarët e KMSH-së z. Bujar Spahiu dhe z. Skender Bruçaj, si dhe z. Dorian Demetja, drejtor i Burimeve Njerëzore pranë KMSH-së.

Kryetari në detyrë H. Selim Muça në fjalën e tij falënderoi bashkëpunëtorët e ngushtë dhe anëtarët e Këshillit të Përgjithshëm për mbështetjen e vazhdueshme në përmbushjen e kësaj detyre. “Ju falënderoj për mbështetjen dhe besimin që më keni dhënë në çdo moment. Të njëjtën gjë shpresoj ta bëni edhe me pasuesin tim në këtë detyrë të shenjtë e fisnike”, u shpreh z. Muça.

Përfaqësuesit myslimanë i shprehën z. Muça mirënjohjen për kontributin e dhënë në këto vite. Ata vlerësuan gjithashtu rolin e tij efikas në drejtimin e institucionit dhe angazhimin maksimal në kryerjen e detyrës.

Këshilli i Përgjithshëm e shpalli H. Selim Muçën kryetar nderi dhe anëtar i përhershëm i Këshillit të Përgjithshëm të KMSH-së, me motivacionin: “Për kontributin e vyer në konsolidimin e vlerave fetare dhe atdhetare në shoqërinë shqiptare”.

Z. Bujar Spahiu u tërhoq nga gara, duke e quajtur të mjaftueshme dhe një përgjegjësi të madhe detyrën që kryen aktualisht si nënkryetar i KMSH-së. Ndërsa dy kandidatët e tjerë prezantuan platformat dhe vizionin e tyre për të ardhmen e institucionit, duke kërkuar bashkëpunimin dhe kontributin e të gjithë myslimanëve. Gjatë prezantimit pati

diskutime dhe pyetje të ndryshme në lidhje me programin, por edhe mbi çështje që preokupojnë institucionin dhe besimtarët.

Votimi për zgjedhjen e kryetarit të ri u zhvillua në mënyrë të fshehtë. Nga 101 anëtarë që ka Këshilli i Përgjithshëm, në votim morën pjesë 99 vetë. Fitues me shumicë votash u shpall z. Skender Bruçaj.

H. Selim Muça i dorëzoi në shenjë simbolike Kryetarit të ri çallmën dhe xhyben e tij, duke i uruar suksese dhe mbarësi në këtë mandat pesëvjeçar.

Më pas, z. Bruçaj me dorë mbi Kur'an bëri betimin konform statutit përpara anëtarëve të Këshillit të Përgjithshëm, si vijon:

“Betohe në emër të Allahut, se do të vazhdoj me besnikëri e përkushtim urdhrat e Islamit, do të punoj me ndërgjegje të plotë islame për lartësimin e fesë së Allahut, do të zbatoj me përpikëri Statutin

dhe Rregulloren e Komunitetit Mysliman, dhe do të punoj me ngulm për forcimin e ndjenjës kombëtare e atdhetashurisë ndër myslimanët e Republikës së Shqipërisë. Allahu më ndihmoftë!”

Në fjalën e tij të parë si drejtuesi më i lartë i institucionit zyrtar të Islamit në Shqipëri, z. Bruçaj ndër të tjera u shpreh: “Jam i ndërgjegjshëm për peshën e rëndë të detyrës që më është besuar mua sot, një amanet i shenjtë i Zotit të Lartësuar dhe një përgjegjësi e madhe ndaj kombit shqiptar. Për ta mbajtur këtë barrë unë jam nevojtar i mbështetjes së Allahut dhe lutjeve të të gjithë besimtarëve. Shërbimin tim ndaj këtyre qindra mijëra besimtarëve e vlerësoj si parësor dhe të paçmuar. Unë zotohem para Allahut dhe ju të gjithëve, që do të punoj me sinqeritet, devotshmëri dhe përkushtim që Komuniteti Mysliman i Shqipërisë të vazhdojë të luajë rolin e tij të





rëndësishëm dhe të përfaqësojë me dinjitet myslimanët shqiptarë brenda dhe jashtë vendit.”

Pas ceremonisë së betimit, anëtarët e Këshillit të Përgjithshëm e uruan z. Bruçaj për detyrën e re.

### **KUSH ËSHTË SKENDER BRUÇAJ?**

Skender Bruçaj ka lindur në rrethin e Malësisë së Madhe më 22 qershor 1976.

Pasi mbaroi arsimin 8-vjeçar në vendlindje, ai u bë pjesë e kontingjentit të parë të studentëve që u nisën nga KMSH drejt Turqisë në vitin 1992.

Kështu më 1996 ai kreu Medresenë Bejkoz në Stamboll, Turqi. Më pas ai kreu studimet në Institutin e Gjuhëve të Huaja pranë Universitetit të Bosforit, ku pasi mbrojti gjuhën angleze, vazhdoi studimet në Fakultetin e Shkencave Sociale – dega Psikologji.

Gjatë viteve 2010-2011 kreu studimet pasuniversitare, ndërsa aktualisht është duke ndjekur studimet për doktoraturë me temë: “Menaxhimi i Cilësisë në Arsim”.

Për disa vite ka punuar si konsulent për disa kompani të huaja.

Në vitin 2008 është emëruar Drejtor i Qendrës së Planifikimit të Karrierës në Universitetin “Epoka”.

Në shtator 2008 është emëruar nga Komuniteti Mysliman si Kryetar

i Komisionit të Hartimit të Dosjes për hapjen e Universitetit “Bedër”. Me hapjen e universitetit ai fillon të japë leksione si pedagog në Fakultetin e Shkencave Humane në Departamentin e Shkencave Islame dhe atë të Drejtësisë në tre gjuhë: shqip, anglisht dhe turqisht.

Në periudhat shtator 2011-dhjetor 2013, krahas lektorit në lëndët Psikologji Sociale dhe Psikologji Islame në universitet, ai ka qenë gjithashtu përgjegjës i Departamentit të Drejtësisë dhe zv/dekan i fakultetit të Shkencave Humane në Universitetin “Bedër”.

Skender Bruçaj ka qenë gjithashtu Drejtor i Qendrës për Edukim të Vazhduar dhe Formim Profesional në Universitetin “Bedër”.

Duke parë përgatitjen e tij të gjerë akademike, Kryesia e KMSH-së, në dhjetor 2013 e emëron atë nënkryetar të KMSH-së.

Z. Bruçaj ka marrë pjesë në shumë konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, si referues në emër të Universitetit Bedër dhe Komunitetit Mysliman të Shqipërisë.

Ai njih disa gjuhë të huaja si anglisht, turqisht, italisht dhe arabisht.

Z. Bruçaj është i martuar dhe ka dy fëmijë (djem).

[www.kmsh.al](http://www.kmsh.al)

“Ka prej  
atyre njerëzve,  
që kanë  
pikësynime  
vetëm për veten  
e tyre.  
Por, ka  
edhe prej atyre,  
që përveç  
pikësynimeve  
personale,  
bartin  
në vetvete,  
edhe për familjen,  
vendin  
dhe ymetin!”

- Me përshtatje,  
nga Dr. Tarik Suvejdjan.

## MYFTINIA SHKODËR URON KRYETARIN E RI TË KMSH, Z. SKËNDER BRUÇAJ

**D**itën e enjte, më 13 mars 2014, një grup imamësh të Myftinisë Shkodër, nën drejtimin e Myftiut, Imam Muhamed Sytari dhe Myftiut të Malësisë së Madhe, H. Edmir Smajlaj, kanë vizituar në zyrën e tij, Kryetarin e ri të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Skënder Bruçaj, me rastin e zgjedhjes së tij në krye të KMSH.

Me këtë rast, vizitorët e kanë uruar kryetarin e ri të Komunitetit Mysliman, me urimet dhe lutjet më të mira për mbarësi dhe sukses në bartjen e amanetit të Thirrjes Islame dhe përballjen me sukses me sfidat e reja, me të cilat ballafaqohet ditë pas dite komuniteti më i madh fetar në Shqipëri.

Edhe Kryetari i ri i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Skënder Bruçaj, është shprehur i gëzuar me rastin e kësaj vizite, që e ka cilësuar si një takim vëllazëror të singertë dhe dashamirë, në një tryezë të madhe familjare, ku secili ka rolin e tij dhe të gjithë punojnë për të mirën e familjes së përbashkët. Ai ka theksuar se të gjithë së bashku, duhet të bashkëpunojmë në drejtim të rritjes së imazhit dhe rolit që ka institucioni i jonë në shoqëri.

Kryetari i KMSH, ka shprehur njëkohësisht gatishmërinë e tij për të ecur në hapat e pararendësve të tij, për ta çuar përpara amanetin e të shkuarve, në shërbim të Thirrjes Islame dhe vlerave të saj shekullore.

Me rastin e kësaj vizite, delegacioni i Myftinisë Shkodër është takuar edhe me Kryetarin e Nderit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Selim Muça, të cilit i kanë uruar shëndet dhe mbarësi.



---

 Rabia Gylten Kardas
 

---

## PA IDENTITET DHE PA TELASHE

**K**a grupe të rinjsh që mund të përkufizohen, që mund të grupohen brenda një kategorie të caktuar. Ata që kanë një identitet, që kanë një telash, i mirë apo i keq qoftë... Ka edhe nga ata që s'mund të përkufizohen... Një rini pa histori, pa dije, të vetmuar dhe ajo që është më e dhembshme, një rini e pashkolluar... Ata nuk mund t'i përkufizojmë me ndonjë identifikim, me ta s'mund të zgjidhim asnjë problem... Qendra studimore SEKAM mori në shqyrtim pikërisht këtë profil të të rinjve të sotëm. Jemi të detyruar t'i kuptojmë këta të rinj, botëkuptimi i të cilëve pak a shumë mund të kuptohet nëpërmjet kësaj shprehjeje: "S'jemi pa Allah, edhe pse thamë se jemi ateistë" Në të kundërt puna jonë vështirësohet, e ardhmja mbetet e errët.

Nëse e nisim aventurën e njeriut, që nga çasti kur është vendosur të krijohet, akoma pa qenë formësuar as trupi i tij, e shprehur ndryshe, atraksioni i vërtetë është momenti i takimit me shejtanin. Kjo i ngjan fillimit të filmave apo romaneve. Që nga ai çast e tutje, përplasjet dhe përpjekjet s'kanë të mbaruar. Jemi apo jo të vetëdijshëm, emocioni mbetet përherë kulminant. Përpjekja mes njeriut, shejtanit dhe nefsit është e vijueshme.

Shejtani njihet për përdorimin e lojrave të kohës. Ai tregohet i kujdesshëm të përdorë çdo mundësi që i shfaqet. Kohët moderne i japin shumë material një përpjekjeje të tillë. Çdo gjë, të cilën njeriu nuk e merr në dorë me qëllimin e mëshirshëm të tij, mund të anojë në një tjetër kahje.

Pavarësisht se lojërat e kohës mund të jenë të ndryshme, në fakt, njeriu mbetet gjithmonë njeri. Natyra e tij është e njëjtë. Ashtu siç ndodh



që toka të mbulohet me barëra të këqinj, për sa kohë që nuk punohet, ashtu siç kërkohet të përpiqeni të pastroni të mbjellurat, në mënyrë që të merrni frytet e duhura, një gjë e ngjashme vlen edhe për njeriun. Çdo çast i yni duhet të përparojë drejt një niveli akoma më të lartë dhe të mos bie pre e shejtanit. Fakti që vetë Pejgamberi ynë lutej të mos binte pre e nefsit, madje "as sa hap e mbyll sytë", përbën një dëshmi të qartë, që të na mësojë një lutje të tillë. E parë në këtë këndvështrim, vetë sureja "Asr" a nuk kërkon të na hapë sytë? Rrezikshmëria për të gabuar është e pranishme përherë, me përjashtim kur këshillojmë për të drejtë dhe durim.

Që nga koha e historisë së pemës së mollëve në Xhenet e deri në ditët e sotme, sprovat tona s'kanë të sosur, dhe kështu do vijojnë deri në Ditën e Gjykimit. Po dita jonë e gjy-

kimit apo dita e gjykimit për mbarë botën? Në një karikaturë zunë vend mollët që lanë gjurmë në historinë e njerëzimit. E para ishte molla e pemës në xhenet dhe e fundit molla që njohim si markë kompjuteri. Pra, është një lloj molle që përfaqëson teknologjinë e informacionit, kohët moderne dhe mediat sociale.

Le të kujtojmë këtu edhe një tjetër mollë që zë vend në Mesnevi. Një burrë, tekta e kish zënë gjumi, në gojë i hyn gjarpri. Një kalimtar aty pranë kërkon ta ndihmojë. Por nëse do i tërhiqte vëmendjen duke i thënë se je dukë ngrënë gjarpër, burri do përkeqësohej. I jep për të ngrënë si me zor një mollë të prishur. Më pas e vë të vrapojë me detyrim nën diellin përvëlues. Burri djersitet së tepërmi dhe ashtu rënkueshëm i drejtohet kalimtarit duke i thënë që, pa shiko se ç'vuajtje më dhe. Më së fundmi stomaku i rëndohet keqazi dhe

*Shumë prej të rinjve sot merren me fjalë boshe. Çdo gjë që tërheq vëmendjen është e pranueshme, çdo çështje e shohim si diçka qesharake. A nuk janë këta fëmijë që kur ishin të vegjël u thuhej: “Pusho ti, nga e di këtë!”, kur u rritën pak iu tha: “U rrite ti që po flet!”, kur erdhën në shkollë u thanë: “feja na çoi në prapambetje”, në xhami iu tha: “Allahu e bën të ngurtë”, një fjalë e urtë u tha: “Malli i shtetit është për të gjithë, kush nuk e merr është i pavlerë”, ndërsa legjendat u thanë: “Nuk preket harami”.*

ç'kishte përbrenda i nxjerr jashtë. Më pas e kupton se kalimtar i kish bërë një të mirë të madhe. Tani le ti lëmë mënjanë edhe këto molla të prishura.

Ku të ketë ndonjë gropë apo kanal, ujërat nisin e mblidhen aty. Ku të jenë hedhur mbeturina, ditë pas dite të tjera mbeturina mblidhen aty. Ku të ketë ndonjë dobësi të gjitha shikimet mblidhen aty. E sigurtë është se nëse këtë tërësi nuk e mbajmë të fortë, nuk e pastrojmë, të tilla vështirësi dhe probleme do na ndjekin përherë. Ose mendoni pastrimin e një rruge ose pastrimin e një shpirti. Një njeri që nuk ndjek rrugën e drejtë, edhe nëse lihet në rrjedhën e tij, natyrisht do ketë mangësi dhe shtrembërime të shumta, e për më tepër në këtë kohë. Pasi shejtani dhe rrethi i tij janë përherë në krye të detyrës. Çdo vizion dhe botëkuptim që synon lirinë duke iu shmangur rregullave, traditave dhe moralit, në fakt nuk bëjnë gjë tjetër veçse duke i larguar këta i mundësojnë afrimet shejtanit.

Le ta shohim studimin e SEKAM edhe nga kjo dritare. Mos ta çojmë dëm studimin vetëm nga këto dy parime popullore. Shprehja e lartpërdorur “Nuk jemi pa Allah, edhe pse thamë se jemi ateistë” përmbledh vetëm një pjesë të studimit. Ky studim i bërë për të rinjtë, në fakt sjell një alarm për mbarë brezin e ri.

E njihni besoj konceptin “Rrethi

vicioz” që përkon me një shprehje të përdorur në njërin prej serialeve televizive mjaft popullore të kohëve të fundit ku thuhet “nervozohem sa herë që mendoj, mendoj sa herë që nervozohem”, ku dy pole të kundërta mbështesin njëra-tjetrën. Pikërisht, le ta shohim studimin në fjalë edhe në këtë këndvështrim. Pasi fjali të tilla si: doli televizori dhe u shkatërrua morali i fëmijëve apo është përhapur shumë media sociale dhe për rrjedhojë nuk ngeli nder gjëkund, të them të drejtën më kujton psikologjinë e fajësimit të tjetrit. Një lloj fajësimi, në thelb të së cilit qëndron heqja e përgjegjësisë nga vetvetja. Ç'të them nesër në ditën e llogaridhënies? Zoti im, seriali ishte mjaft tërheqës, prandaj dhe më iku koha e namazit? M'i pëlqente fotografite që bëja, më dërgonte komente interesante, prandaj edhe më iku koha e namazit? T'i them që i thashë tim biri të ngrihet dhe të falte namazin, por nuk ngrihej dot nga kompjuteri? T'i them që unë e dërgova në xhami, e bëra detyrën time?

Dëshiroj ta shohim këtë studim edhe në këtë aspekt që edhe vetes t'i kërkojmë pak llogari. Në të kundërt, disa shifra që shohim nuk janë thjeshtë një rënkim për ne. Pyetja se ku po shkon rinia është për të ndërgjegjësuar vetveten. Pasi rinia nuk ecën vetvetiu drejt të keqes. Me çdo përgjegjësi që anashkalojmë, rinia humbet prestigjin moral. Nuk

i krijon të rregullta lidhjet e saj. Kështu, nisin edhe përçarjet kur ka dallime mes atyre që u mësohen dhe atyre që shihen në praktikë. Ndërkohë që nga njëra anë sheh, mëson ngjarje virtuozë, nga ana tjetër sheh që marka, paraja dhe fama kanë bërë një bujë të madhe. Nuk mund ta fsheh urinë shpirtërore, ndërkohë që vrapon pas kënaqësive fizike. Më pas thotë se jam ateist, por ndërkohë i beson Allahut. Më pas thotë jam mysliman, por nga ana tjetër nuk bie në kundërshtim me një lidhje jashtë martesore.

Shumë prej të rinjve sot merren me fjalë boshe. Çdo gjë që tërheq vëmendjen është e pranueshme, çdo çështje e shohim si diçka qesharake. A nuk janë këta fëmijë që kur ishin të vegjël u thuhej: “Pusho ti, nga e di këtë!”, kur u rritën pak iu tha: “U rrite ti që po flet!”, kur erdhën në shkollë u thanë: “feja na çoi në prapambetje”, në xhami iu tha: “Allahu e bën të ngurtë”, një fjalë e urtë u tha: “Malli i shtetit është për të gjithë, kush nuk e merr është i pavlerë”, ndërsa legjendat u thanë: “Nuk preket harami”. Si mendoni ju, tani këta të rinj të mos mendojnë me vete që “Po s'u bëjnë ne skizofrenë kush do bëhet”?

Njeriu përherë është i njëjti njeri. Edhe pretekstet janë të njëjta.

E marrë në aspektin e veçantive dhe specifikave, një prej sprovave më kyçe, ku gjithsecili shfaq veten e tij është padyshim edhe media sociale. Në çdo rrethanë, si të sillesh ashtu je. Përse u bë kaq e rëndësishme për një çast kjo për ty, tha miku im Mesnevi, në këtë pikëpyetje ka miqësi të ngushtë. Pasi ky nuk është një përmirësim, është një anulim. Një individ që qëndron jashtë ambientit fetar mbetet i paplotësuar me ndërgjegjen për ta bërë një punë edhe më mirë. Është e qartë ardhja e shejtanit nga e djathta. Nëse do ketë një terren të duhur, do ecë në një rrugë të rregullt, qoftë kjo edhe



**Kemi kohë  
për t'u marrë  
me qëndistari,  
me gatime,  
të ndjekim ndeshjet  
apo edhe komentet e  
lajmeve dhe nuk kemi  
kohë të flasim me  
fëmijën tonë.**

një rrugë imagjinare.

Një zonjë e mbuluar, banore e një zone ku në përgjithësi jetojnë njerëz me bindje të theksuara fetare, e regjistron fëmijën e saj në një kurs matematike të hapur nga një shoqatë. Nuk kishte dijeni kjo nënë për ato që bëheshin në këtë kurs, të cilën ajo e mbronte teksa thoshte se nuk kishte gjë të keqe, pasi matematikë po mësojnë, e për më tepër që është falas. Nuk ishte në dijeni kjo nënë për shqetësimet e fëmijëve në këtë kurs.

Në një seminar ku shpjegohet se si programet televizive programojnë trurin e fëmijëve, pas një pyetje që nëna ofron kur thotë: "Çfarë të bëjmë tani?" dhe pas përgjigjes që i ofron ligjëruesi kur i thotë "Nëse fëmija dëshiron të ndjekë pikërisht atë film, uluni edhe ju bashkë me të dhe ndiqeni" vjen edhe përgjigja e nënës "Nuk kam kohë!"

Kemi kohë për t'u marrë me qëndistari, me gatime, të ndjekim ndeshjet apo edhe komentet e lajmeve dhe nuk kemi kohë të flasim me fëmijën tonë. Në shoqërinë e sotme sipas një studimi baballarët flasin vetëm 4 minuta me fëmijët e tyre, nga ku 2 minuta për të pyetur nëse i ka bërë apo jo detyrat. Një baba i ri, të cilin e njoh prej kohësh, e merr në prehër të birin për ta qetësuar, e përqafton fëmijën si për ta bërë që ta dëgjojë, pusho – i thotë - më dëgjo mua.

Fëmija i mbytur në vaj mundohet ta dëgjojë të atin. Babai flet mjaft bukur me të dhe pandeh se problemi u zgjidh. Nuk e kupton i shkreti baba se fëmija mundohet mos ta shohë në sy babain.

Rinia e sotme s'mund ta kuptojnë gjuhën e shkruar të historisë pa histori. Arsimi ka vite që ofron mësimin e anglishtes dhe atë të pasdemokracisë, por nuk arrin t'ua mësojë. Të rinjtë janë të painformuar, pandehin se nuk i besohet askujt, e veçanërisht as babait, pra këta të rinj nuk kanë njeri t'u qëndrojnë pranë. Mos vallë është për mos u shfaqur si të vetmuar, por kjo i bën akoma më shumë egositë. Kërkojnë mëshirë pa përpjekje. As që e marrin mundimin për të bërë diçka. Ashtu siç e shkelmojnë të lënduarin e rrugës, as që e marrin mundimit ta ndihmojnë. Gjëja më e madhe që mund të bëjnë është të krijojnë një lloj distance sa për t'u dukur që kanë qenë të pranishëm.

Duhet të interesohemi me të rinjtë. Kemi nevojë për dikë që të kuptojë gjuhën, nefsën dhe ambientin ku të rinjtë jetojnë dhe të jetë udhërrëfyes për ta. Gjithashtu dikush që të ecë në të njëjtën rrugë bashkë me ta. Kemi nevojë për njerëz që e jetojnë fenë, i kuptojnë të rinjtë, që i shohin ata me syrin e mëshirës.

Fatkeqësisht na mungon një traditë, një sistem që e ndërton iden-

titetin e të rinjve me një vizion dhe botëkuptim që jetën e kësaj bote e sheh nga dritarja e Islamit. A nuk ju duket interesant fakti që ata të cilët veten e quajnë myslimanë, pra ateistët aktualë bëjnë gjynahe nga më të ndryshmet aty ku nuk ka gjurmë njeriu, situatë e cila i ngjason një ateisti të njohur si i tillë, i cili fal namaz?

Nuk është e drejtë në fakt t'i drejtohem vetëm një aspekti, ndërkohë që jemi në kërkim të fajtorit, e nëse vërtet duhet, le t'ia drejtojmë gishtin vetes. Nuk është më anormale të shohësh probleme të tilla në jetën e nipërve të një brezi që u shkëputën nga rrënjët dhe historia e tyre, që u penguan të jetonin fenë e tyre, që u frikësuan dhe u torturuan nëpër biruca burgjesh.

Meqenëse dija që kemi është e mangët dhe problemet etike janë të shumta përpiqemi të ekzistojmë me paraqitjen, fuqinë dhe popullaritetin që kemi. Dhe është kaq i mbushur ky shesh, nuk hezitojmë t'u vëmë shkelmat të tjerëve vetëm e vetëm të ngrihem, të dukemi diku apo të dalim më në pah.

Shumë prej nesh nuk dallojnë aspak nga aktorët që shfaqen të lumtur nëpër skena të zbukuruara me kostume të marra me qera. Prapaskaena pastaj është e dhimbshme.

Ne na duhet një politikë e mirëqëndrueshme rinore. Duhet t'u qëndrojmë më afër të rinjve. Duhet dikush që të kuptojë gjuhën, nefsën dhe botëkuptimin e të rinjve, t'i udhëzojë ata, por në të njëjtën kohë të ecë së bashku me ta. Duhet njerëz praktikues të fesë, që e kuptojnë të riun dhe e shohin atë me dhembshuri.

Në kohën e sotme ka shumë njerëz në mesin tonë që hanë molla të kalbura dhe natyrshëm sëmuren. Le të shpresojmë t'i pastrojmë edhe këta elementë dhe të rrimë të qetë.

*Përktheu nga turqishtja*  
**Evans Drishti**

## MYFTIU PRITI DREJTORIN E SHOQATËS "BURIMI"



**D**itën e enjte, më 20 shkurt 2014, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, priti një një takim të përzemërt pune, Drejtorin e Shoqatës "Burimi", z. Sokol Mandi.

Gjatë këtij takimi, Myftiu ka falënderuar kontributet e Shoqatës "Burimi", në kuadër të gjallërimit të jetës fetare në Shkodër, nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme bamirëse, intelektuale, fetare, arsimore e botuese.

Myftiu ka vlerësuar se në rrugën e bashkëpunimit dypalësh, është bërë e mundur të realizohen disa projekte të dobishme, si ai i mbështetjes së duatëve (imamëve të disa xhamive të Shkodrës), kurset e ndryshme verore, ndihmat ndaj nevojtarëve etj.

Njëkohësisht, Myftiu ka kërkuar që këto projekte të vazhdojnë dhe të pasurohen me projekte të tjera të dobishme, për të cilat është diskutuar edhe gjatë këtij takimi.

Nga ana e tij, edhe Drejtori i Shoqatës "Burimi", ka vlerësuar bashkëpunimin dhe mirëkuptimin e Myftinisë Shkodër, sidomos në marrëveshjen e bashkëpunimit dypalësh, që ka forcuar edhe më tej frymën e partneritetit dhe bashkëpunimit për qëllimet e përbashkëta në shërbim të vlerave të Thirrjes Islame.

## Profetit tim të dashur...

- Krenaria e njerëzimit! -

**P**o të shkruaj ty i shtrenjti ynë, sepse e di që në një farë mënyre më pas do të ndihem më mirë. Unë e di që ti je aq i durueshëm, sa që nuk do të mërzitesh nga fjalët e mia. Mora guximin të të shkruaj, sepse kam shumë nevojë për ty, i dashuri ynë. Do doja shumë të gjendeshe pranë nesh, do doja shumë të shihja ato sy, ata dy yje, më të shndritshmit në qiell. Do doja të ndieja lumturinë time, teksa do më rrezatonte, që nga buzëqeshja e deri tek shkëlqimi i syve. E di, i dërguar? Shpeshherë jam aq e mërzitur dhe e pashpresë, sa që më humbet durimi dhe qaj me minuta të tëra, por kur sjell ndërmend durimin tënd të pakrahasueshëm, pavarësisht vështirësive...ngushëllohem. Por sado të mundohem, është e pamundur t'i afroresh fuqisë së durimit tënd. Po, është krejtësisht e pamundur. Eh, i dashur, sa gjatë do flisja për ty, fundja, cili nuk do ta bënte? Te flasësh për ty është sa e lehtë aq edhe e vështirë, pasi fjalët janë aq të varfra dhe të pamjaftueshme, sa që e ndien veten të paaftë. Kjo nuk ka aspak rëndësi, ajo që vlen më shumë, është fakti që të dua shumë. Aq mall kam për ty sa po digjem. Por kur e mendoj më gjatë, më mirë të digjem nga malli për ty, sesa nga zjarri i Xheheneimit. Kam shumë frikë, i dashuri i Allahut, kam me të vërtetë frikë. I frikësohem faktit që jeta nuk do më mjaftojë ta falënderoj Krijuesin

për mënyrën si më përsosi, duke më rritur pa të meta. Frikësohem gjithashtu nga fakti që mund të mos mjaftojë jeta të kërkoj falje, që mund të kem mërzitur Krijuesin tim, por kam shpresë në mëshirën e Krijuesit, kam shpresë nën hijen e pemës së Tij të mëshirës. Jam njeri, e si rrjedhojë, jam e gabueshme, por ndoshta kam pafytyrësinë të them që e dua me çdo qelizë timen Xhenetin. E dëshiroj sepse shpresoj takimin me ty. Nuk e di në fakt sesa te denjë janë sytë e mi të shohin fytyrën tënde. Nuk e di sesa e fortë dhe rezistente mund të jetë zemra ime për ta përballuar takimin me ty. Eh, ai moment...me të vërtetë do të ishte më i magjishmi, sepse prezenca në Xhenet do të thoshte jo vetëm që kam fituar kënaqësinë e Allahut, por edhe takimin me ty, ëmbëlsira e ditëve të mia të kri-pura, gëzimi i çdo çasti hidhërimi, qetësia e shpirtit tim, bukuri rrëzëllitëse... pasha Krijuesin në dorën e të cilit ndodhet shpirti im, të dua me gjithë fuqinë e shpirtit tim, dua çdo fije nga flokët e tu, çdo fjalë që është nxjerrë nga goja jote, sepse ti dhe Krijuesi jeni ata që e meritojnë të dashurohen, Krijesa më e dashur e Allahut. Me shpresën që Ditën e Gjykimit do të jesh ti ai i cili do më presë në derën e Xhenetit, po e mbyll këtë letër. Shpresoj mos të të kem bezdisur me bisedat e mia të tejjgjatura, por më kupto, i dashur profet, nuk ngopem së biseduari me ty. Me lotët që nuk po i kontrolloj dot, më duhet të të them mirupafshim, In sha Allah në Xhenet, krenaria jonë më e madhe. Me respekt të pandërprerë, e dashuri që arrin kulmin, një grimcë e vogël nga umeti yt i madh.

Indira Krymi



## MYFTIU PRITI AMBASADORIN E TURQISË, Z. HIDAYET BAYRAKTAR



**T**ë xhumanë, më 21 shkurt 2014, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, priti në një takim zyrtar, Ambasadorin e Turqisë në Shqipëri, z. Hidayet Bayraktar, që vizitoi për herë të parë Shkodrën, pas akreditimit të tij në Shqipëri, disa muaj më parë.

Gjatë takimit, Myftiu ka vlerësuar historinë e përbashkët të dy popujve, ku ka përmendur se për shekuj të tërë, shqiptarët dhe turqit në Kalifatin Osman, kanë drejtuar botën, duke dhënë shembullin më pozitiv në administrim, dije, kulturë etj.

Ndërsa ambasadori turk, pasi ka falënderuar Myftiun për mikpritjen, ka vlerësuar se në Shqipëri, ai ndjehet si në shtëpinë e tij, për shkak të emëruesve të përbashkët që kanë dy vendet, si në kulturë,

tradita, besim etj.

I shoqëruar edhe nga koordinatori i TIKA-s për Shqipërinë, prof. dr. Birol Çetin, ambasadori turk ka dhënë shtesën e shumëpritur për angazhimin e TIKA-s për mbështetjen e projektit për rehabilitimin e Xhamisë së Plumbit dhe zonës përreth vakëfit të saj.

Gjatë këtij takimi, Myftiu i ka dhuruar ambasadorit turk një portret të komandantit Hasan Riza Pasha, duke vlerësuar se ai ishte dhe mbeti komandanti dhe mbrojtësi i Shkodrës nga pushtimi malazez, në vitin 1913.

Më pas, bisedat kanë vazhduar rreth bashkëpunimit të Myftinisë Shkodër me TIKA-n, në lidhje me projekte të ndryshme që ka Myftinia Shkodër në rrugëtimet e saj.



H. Ibrahim Kaduku

**A e keni  
ditur se Hoxha  
Ibrahim Kaduku  
(1869-1949),  
ka një libërth  
në gjuhën arabe,  
parathënien e të cilit  
e ka shkruar  
dijetari i shquar,  
fakihu dhe autori i tefsirit  
të njohur me 30 vëllime,  
Muhammed Et-Tahir  
ibn Ashur  
(1879 - 1973)**

# INTERVISTË ME HIRËSINË E TIJ, SHEJKH SHUAJB ARNAUTI

**Fillimisht, kemi dëshirë të njohim biografinë e jetës suaj, ku keni lindur, rritur, shkolluar dhe cilët kanë qenë mësuesit (shujukh) tuaj etj:**

Jam rritur si nxënësit e tjerë të diturisë, ku dituria mu bë e dashur për mua. Punoja në tregun Saruxha në lagjet e vjetra të Damaskut dhe në dyqanin tonë pas dreke (iqindisë) na vizitonte një dijetar (shejkh). Njerëzit e kishin traditë që në këtë kohë nuk punonin dhe pushonin. Ky dijetar vinte te ne për hir të Allahut dhe na mësonte rregullat e gjuhës arabe. Krahas kësaj na mësonte edhe Sherhul kenz të Shejkh Abdulhakim El-Afgani (r.h) dhe El-Hashijetu. Të dy këto libra i kam mësuar prej këtij dijetari, Allahu e mëshiroftë.

Gjithashtu kam mësuar prej Shejkh Salih Farfurit disa libra: Tefsir En-Nesefij, Sherhul Menar në Usul, Sahihul Muslim, librin e Buharit të Ajniut (r.h), Umde. Krahas këtyre librave kam mësuar prej tij edhe metaforë, Sherh Ibn Akil, dhe filozofi, si filozofia e Suriut, e cila sot nuk ka më vlerë.

Prej mësuesve të mi janë edhe: Shejkh Sulejman Gavoçi, i ati i Vehbi Sulejman Gavoçit. Kam mësuar gramatikë (nahv) sipas metodës osmane, ku fillohej me avamil, me idhhar të Berxhuvisë, pastaj "El-Kafijete" të Ibn Haxhib, e cila ishte e njohur dhe e përhapur në Lindje. Kam lexuar "Merakil-Felah" dhe "Hashije" të Et-Tahtavit. Gjithashtu kam mësuar nga babai i Shejkh Nasir Albanit librin e fikhut Hanefi të Ebul Hasen El-Kudurit, i cili është libër reference prej librave të medhhebit Hanefi. Kam mësuar prej tij edhe mesele shkencore, ku për tre vjet që qëndrova te ai, unë pyesja dhe ai më përgjigjej, Allahu e mëshiroftë. Pra, dituria m'u bë shumë e dashur.

Pasi mbarova tetë vjet shkollë m'u lejua të punoja mësues në institutin "El-Feth el-Islami", i cili përfshinte një numër të madh studentësh, nga shkolla e mesme dhe ajo e lartë, gjithashtu edhe master. Ata studentë që dëshironin të vazhdonin edhe doktoraturën shkonin dhe e plotësonin në Egjipt. Këtu qëndruam dy vjet duke i mësuar studentëve shkencë islame dhe ato të gjuhës arabe.

Pastaj, me formimin e kushteve iu drejtova me kënaqësi studimit të Sunetit profetik. U thellova shumë në këtë rrugë duke absorvuar librat e Mustalahit (shkencë e terminologjisë së hadithit) si: "Mukaddime ibn Salah", "Tawdih el-efkar lil-San'ani", "Sherh en-nukhbeti l-ibni Haxher". Kështu fillova dhe gjithmonë e lusja Allahun (xh.sh) të më bënte në grupin e hadithologëve (dijetarëve të hadihti). Desh Allahu e ma pranoi lutjen time dhe kështu vazhdova në këtë rrugë; që 40 vjet e deri tashi unë redaktoj libra, jap shkencën e hadithit dhe kam nxjerrë (redaktuar) më shumë se 200 vëllime rreth kë-saj teme.

**Shumë herë dëgjojmë lart e poshtë se interesimi për Senedin (vargun e transmetuesve) ka mbaruar dhe nuk është e nevojshme të merresh me të, por në të njëjtën kohë shohim të tjerë që janë zhytur në të, madje deri edhe te Senedi (vargu i transmetuesve) të Buhariut dhe Muslimit, në studimin e tyre dhe gjykimin për to, prandaj cili është mendimi juaj për këtë?**

Dua të them se mendimi im për studimin e Senedit (vargut të transmetuesve) akoma është çështje interpretimi (ixhtihadi) ... vendimet nuk janë përgjithësuese, sepse çdo njeri kur merret me studimin e Sene-

dit ka të bëjë me bindjen e tij rreth atij hadithi që ka marrë në studim. Po qe se arrin në ndonjë përfundim, ndoshta në sytë e të tjerëve mund të jetë i gabuar, ose mund të jetë i saktë për sytë e disa të tjerëve. Për këtë El-Mundhiri (r.h) ka shkruar një libër rreth kësaj çështje në të cilin ka sqaruar se gjykimi (vendimi) për hadithet është gjykim ixhtihadij (interpretues) që është i lidhur me bindjen e studiuesit, aftësinë dhe zotësinë e tij, të cilat ka arritur t'i fitojë për një kohë të gjatë si dhe gjatë praktikës së studimit të Senedeve (vargjeve të transmetuesve).

Për sa i përket pyetjes se studimet e Senedeve kanë përfunduar, mund të themi se: Studimet e Senedeve (vargjeve të transmetuesve) kanë treguar plotësisht interes, ku unë jam njëri prej atyre që kanë punuar në kë fushë. Ka edhe profesorë të tjerë, të cilët kanë marrë pjesë në studimin e Senedeve duke i dhënë hakun kësaj fushe. Dhe, duke u nisur nga grumbulli i punëve të tyre dhe i punës sime them që 90% e Sunetit profetik është redaktuar nga ana e Senedit (vargut të transmetimeve) dhe është dhënë vlerësimi për të.

Ndërsa, për sa i përket nakdulmeten (kritikës së përmbajtjes së hadithit), pa dyshim dhe pa asnjë mëdyshje në shkencën e hadithit, kur dikush studion Senedin, patjetër duhet të studiojë edhe Metnin (teksti i hadithit). Sepse, hadithin e saktë e kanë përkufizuar si hadith ku transmetuesit e tij janë të saktë dhe të përpiktë... etj. E kanë përkufizuar që të mos jetë i veçantë (shadh), apo i parregullt, sepse veçantësia dhe parregullsia janë pjesë e kritikës së përmbajtjes (Metnit) dhe vargut të transmetuesve (Senedit). Si shembulli i këtyre gjërave, e them shkoqur se nuk mundet njeri ta arrijë këtë nivel,

përveç se pas një mudi të madh, praktike të gjatë, zotësi shtesë dhe devotshmëri prej Allahut (xh.sh), e cila e mbron studiuesin që të mos devijojë nga rruga e drejtë. Për këtë unë sugjeroj, që për kritikën e përmbajtjes (Metnit) duhet të mblidhen një grup dijetarësh, dua të them: Të krijohet një këshillë shkencor për të studiuar përmbajtjen e hadithit (Metenin) dhe t'i vlerësojë ato. InshaAllah do të jetë ky mendim i drejtë, sepse grupi, në dashtë Allahu është më tepër i saktë (i drejtë) se sa mendimi i një personi të vetëm, veçanërisht për këto gjëra.

**Dy libra rreth shkencës së hadithit (el-Xherh ve et-Teadil): Tehdhib el-kemal të Imam El-Mizzij dhe Et-Tehdhib të Ibn Haxher El-Askalani, cila është rëndësia e këtyre dy librave për punonjësën e redaktimit? Dhe, a mund të mjaftohet vetëm me njërin prej tyre?**

Ai që punon në shkencën e hadithit (el-Xherh ve et-Teadil) e ka shumë të domosdoshme të ketë librin "Tehdhib el-Kemal", sepse transmetuesit disa herë vinë kështu: Muxhahid, por kush është Muxhahidi? Kur kthehet te libri "Tehdhib el-Kemal" i Hafidh El-Mizzij, aty do të gjejë të gjithë mësuesit dhe nxënësit, të cilët kanë transmetuar prej këtij njeriu që e ka emrin Muxhahid. Kështu që, pas kësaj ai mund ta përcaktojë se kush është personi, prandaj është shumë e domosdoshme ta ketë këtë libër. Libri "Tehdhib el-Kemal" ka përfshirë "gjashtë librat"<sup>1</sup>, d.m.th të gjithë mësuesit e transmetuesit, të cilët kanë transmetuar prej tij, hadithet e tyre në "gjashtë librat" dhe nxënësit e tyre janë të përmendur në biografitë e secilit

prej tyre. Kjo është një gjë shumë e madhe! Pastaj, shejkh Mizzij (Allahu e mëshiroftë) transmeton nga dijetarët e hadithit (el-Xherh ve et-Teadil) thëniet e tyre dhe ndonjëherë edhe i vë në peshore mendimet e njëritjetrit. Prandaj, patjetër që studiuesi duhet t'i grumbullojë këto thënie, të cilat janë thënë për transmetuesin, e më pas t'i studiojë, t'i peshojë dhe të arrijë në përfundimin e duhur.

Ne e kemi shqyrtuar El-Hafidh ibn Haxher dhe ndoshta kemi për të rreth një mijë komente, d.m.th gati çerekun e librit e kemi plotësuar për të (Allahu e mëshiroftë). Këtë punim do ta gjesh në librin me titull: Tahrir et-tekrib.

Ndërsa libri i El-Hafidh ibn Haxher është përmbledhje e librit Tehdhib el-kemal, ashtu siç e ka thënë edhe autori vetë në parathënien e librit.


**Te disa nxënës të dijes është përhapur interesimi për gjykimin ndaj hadithit, i saktë (sahih), apo i dobët (daif) dhe nxënësit e dijes që punojnë në redaktim tregojnë rëndësi të përmendin hadithin, a është i saktë, apo i dobët, cili është mendimi juaj për këtë? A ka ndonjë metodë që nxënësit e dijes duhet ta ndjekin për gjykimin (vlerësimin) e hadithit?**

Këta njerëz të vlerësojnë (gjykojnë) pasi t'i kenë plotësuar mjetet kërkuese, por nuk duhet t'i shkruajnë në libër, përveç se kur kritika t'i bëhet zotësi, me të cilën munden të dallojnë të saktën dhe jo të saktën. Naty-


risht, në qoftë se personi nuk i shikon punimet e atyre që kanë qenë përpara tij, ai nuk do t'ia qëllojë aspak kësaj punë. Duhet patjetër tu kthehet thëniet e hadithologëve dhe imamëve të vjetër dhe sidomos në hadithet, për të cilat ka mospajtim, t'i studiojë me seriozitet, pastaj t'i vlerësojë (gjykojë) sipas mendimit të tij. Kjo kështu është dhe nuk ka rrugët tjetër, ndërsa të njohë vetëm diçka prej Musatalahit (shkenca e terminologjisë së hadithit), të lexojë disa libra shkencorë dhe tua tregojë ato njerëzve, kjo gjë bënë më shumë keq, se sa mirë.

**Qarkullon te disa të ditur se dy librat e saktë të Buhariut dhe Muslimit kanë të meta, duke u argumentuar se në to ka hadithe "të varura" (mualaka) dhe "të veçanta" (shadh), cili është koment juaj për këtë?**

Këto fjalë nuk kanë asnjë grimcë shkencore. Libri i Saktë i Buhariut (Allahu e mëshiroftë), them për të çfarë ka thënë Abdulgani El-Makdesi: "Sikur një njeri të betohet për divorc, se hadithet e Buhariut janë të gjitha të sakta, në varg transmetimi



1. Gjashtë librat në hadith "kutub es-sitte" janë: Librin i Saktë i Buhariut, libri i Saktë i Muslimit, libri i Ne-saiut, libri i Tirmidhiut, libri i Ebu Davudit dhe libri i Ibn Maxhes.



(musnede) dhe pa këputje në zinxhirin e transmetuesve, divorci për të nuk vlen." Sepse Imam Buhariu, pa asnjë dyshim dhe mëdyshje, të gjithë hadithet e tij në këtë libër janë të saktë, edhe ai e konfirmon prerazi këtë, d.m.th: Kjo sipas bindjes së tij, të gjitha hadithet e lidhura (musnede - të pa shkëputura në vargun e transmetuesve), të cilat i ka sjellë në librin e Saktë të tij, ato janë të sakta. Por, nëse dikush vjen pas tij dhe e kundërshton, kjo gjë është mospajtim interpretuesish në varësi të disa haditheve, të cilat janë kritikuar ndaj Buhariut (r.h).

Unë mendoj se nxënësi i dijes duhet gjithmonë dhe përherë t'i shikojë hadithet e Buhariut dhe të mjaftojë

me atribuimin e tij, sepse atribuimi i tij është tregues i saktësisë. Kritika që i drejtohet Buhariut është kritikë që nuk ka lindur nga dituria. Nëse e lexon parathënien e Fet'hul Barit për hadithet, të cilat pretendohen ndaj Buhariut se ato janë të dobëta në vargun e transmetuesve (sened), apo flitet për transmetuesit e tyre, do ta shikosh se si autori i këtij libri e mbron saktësisht Imam Buhariun.

Po, vetë Buhariu në disa herë sjell hadithe "merfua", pastaj i transmeton "meukufe" për të treguar se hadithi "meukuf" është i saktë sipas mendimit të tij. Ai në këtë libër ka interpretimet e tij që duhet patjetër të dihen. Unë them atë që dijetarët kanë thënë: Pas librit të Allahut

(Kur'anit) nuk ka libër më të saktë, se sa libri *Sahihu i Buhariut* (r.h).

Ndërsa libri i Muslimit është në një shkallë më të ulët, por Muslimi në librin bazë transmeton hadithe të sakta, e më pas në verifikim tregohet lehtësues.

Në qoftë se një hadith transmetohet me Sened (varg transmetuesish) të saktë, pastaj vjen në një rrugë të dytë, të tretë dhe të katërt i njëjti hadith, por rruga ka dobësi të vogël, ai (Muslimi) e sjellë atë, sepse në Mutabeatë dhe Shawahid e përmend këtë gjë.

**Kemi dëshirë, zotëri i nderuar të na sqarosh metodën më të saktë në sjellje me personat, për të cilët dijetarët e hadithit (el-xherh ve et-teadil) nuk kanë folur për ta, pra nuk kanë dhënë ndonjë opinion rreth tyre, d.m.th kanë heshtur për ta?**

Për ata, të cilët nuk është folur rreth tyre, patjetër duhet që hadithet e tyre të analizohen, sidomos hadithet në Musnedin e Imam Ahmedit. Në qoftë se gjejmë një transmetues, ndaj të cilit nuk është folur, por prej tij kanë transmetuar më shumë se tre-katër persona dhe askush nuk i ka mohuar këto transmetime prej tij, atëherë hadithet e tij i quajmë "Hasen" (të mira), që do të thotë se ato vlejnë si argument, përveç në ato raste kur këto hadithe kundërshtohen prej ndonjë hadithi të saktë e të pa shkëputur (musned).

**Cila është metoda juaj për transmetuesit ndaj të cilëve ka mendime të ndryshme (xherhan ve teadilen)?**

Të them të drejtën, ne kemi mësuar nga librat e shkencës së hadithit (el-xherh ve et-teadil) se disa njerëz janë strikt dhe disa të tjerë janë lehtësues. Kështu që, gjejmë transmetues (ravi) se, sado që të jetë i besueshëm (thikah), në disa raste sjell ndonjë hadith, i cili është i mohuar (munker). D.m.th deri edhe transmetuesit e besueshëm (eth-thikat),

të cilët janë transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi, pra nuk ka njeri që mund tu shpëtojë gabimeve, sado që mundohet të jetë i përpiktë. Për këtë edhe Imam Shafiu (r.h) thotë: Të besueshëm (eth-thikat) për ne quhen ata njerëz që janë shumë të saktë dhe gabojnë pak dhe, të dobët (ed-daif) për ne janë ata njerëz që gabojnë shumë dhe janë pak të saktë. Mbi këtë bazë ne ecim dhe këto i gjen te libri Tahrir et-tekrib, të sqaruara në mënyrë të qartë dhe të hollësishme. P.sh kur refuzojmë Hafidh ibn Haxher që thotë për ndonjë transmetues (ravi): I drejtë (saduk), unë them: I besueshëm (thikah), e ka bërë të besueshëm (veth-thakahu) filani, filani e filani. Pra, kur shohim se grupi i dijetarëve të mëdhenj e të përpiktë e kanë bërë të besueshëm (veth-thaku) atë transmetues, atëherë ne nuk i kushtojmë rëndësi fjalës së Ibn Haxherit, i cili në këtë rast e ka tejkaluar të vërtetën (nuk ia ka qëlluar).

### **Kenë punuar për redaktimin e librit Të saktë të Ibn Hibanit, a mund të na jepni një përmbledhje të shkurtër rreth metodës së Ibn Hibanit për librin e Saktë të tij?**

Metoda e Ibn Hibanit në librin e Saktë të tij është e ndryshme prej metodës, të cilën ai ka ndjekur për librin e tij të "Të Besueshmit" (Eth-thikat).

**Së pari:** Hadithet e Ibn Hibanit janë të shumta, përveç 2050 hadithe, ose afërsisht me këtë numër, të gjitha i ka transmetuar Buhariu dhe Muslimi dhe autorët e tjerë të librave të saktë. Por, ai edhe merr ... d.m.th transmeton përmes mësuesve dhe dijetarëve të tij, prej të cilëve ka transmetuar. Ndërsa hadithet, të cilat ai nuk i ka shqyrtuar, por ato i kanë shqyrtuar autorët e Suneneve, metoda e tij është metoda e librit të Saktë. Këtë e kam mësuar gjatë praktikës, sepse unë i kam studiuar të gjithë transmetuesit. Ndërsa, dijetarët prej të cilëve ka transmetuar, ata janë të gjithë të besueshëm (thi-

kat). Ai ka arritur të njohë më shumë se dy mijë dijetarë dhe është përqendruar te 200 prej tyre në librin e tij të Saktë, të cilin e ka mbështetur te këta transmetues që i ka bërë vetë të besueshëm (veth-thakahum) dhe i ka njohur cilësitë e tyre. Në parathënien e këtij libri, unë kam dhënë biografite e tyre dhe i kam vendosur në gradën e vet secilin, të besueshëm (thikat), apo të dobët (daif).

Dhe për sa i përket transmetuesve, të cilëve Ibn Hibani ua ka saktësuar hadithet e tyre, disa hadithe të paktë në numër, nuk është rregulli dhe tradita e Ibn Hibanit t'i bëjë të besueshëm (tev-thik) njerëzve të panjohur. Kjo nuk është metoda e tij dhe konsiderohet si kontradiktore e metodës së librit Të Saktë të tij (r.h). Në librin e Saktë të tij nuk gjen asnjë prej atyre personave, të cilët i kanë bërë të besueshëm dikush tjetër, përveç autorit, shumë shumë pak. Pjesa tjetër, të gjithë janë prej atyre që i kanë bërë të besueshëm (veth-thakahum) të tjerët, përveç Ibn Hibanit. Për disa prej tyre ka folur ndonjë diçka të vogël, d.m.th ai (libri) qëndron shumë më lart se sa Mustedreku i Hakimit dhe gjithashtu edhe më lart se Sahihi (libri i saktë) i Ibn Khuzejmes. Sepse Ibn Khuzejme (r.h) ka sjellë në librin e tij disa hadithe, madje shumë hadithe për të cilat akoma pa mbërritur në çerekun e librit, thotë: Në qoftë se lajmi (haberi) është i saktë. Kështu pra, ai ka sjellë në hadithet e tij këtë lloj, ku Ibn Hibani është krejt i pastër prej këtij lloji hadithesh.

**Në fund të takimit, kemi dëshirë që lexuesve të faqes sonë, tu japësh disa këshilla, Allahu (xh.sh) ta shpërbleftë me të mira, të dhashtë begati dhe diturinë e punën tuaj ta bëftë në peshoren e veprave e përfitoftë sa më shumë Islami dhe myslimanët prej kësaj pune.**

Vëllezërve të mi, të cilët janë kujdestarë të kësaj faqe mos shkruani, veçse ato gjëra që keni dëshirë t'i shikoni në ditën e kiametit dhe ju

bëjnë të gëzuar në atë ditë. Duam që njeriu të mos tregohet sektarist, të ngrejë dikë, e të poshtërojë dikën tjetër. Dua që ata të kenë gjithmonë qëllimin e arritjes tek e vërteta dhe angazhimit në metodën e saktë, në të cilën kanë ecur dijetarët dhe imamët, Allahu qoftë i kënaqur me ta. Këtë gjë dëshiroj prej tyre dhe të jetë devotshmëria e Allahut, motivi kryesor që i shtyn drejt këtij qëllimi.

### **Këshilla juaj për nxënësit e dijes?**

Duhet ta dinë mirë të gjithë nxënësit e dijes, pa përjashtim se hadithi është njëri prej burimeve në të cilat mbështetet interpretuesi (muxhtehidi). Kur'ani është i pari, pastaj Suneti, Konsensusi dhe Analogjia. Këto janë shkallët në të cilat kanë shkelur dijetarët të gjithë, pa përjashtim. Kështu që, Fakihi (juristi) patjetër duhet të jetë haditholog (muhadith), të jetë komentues (mufesir), të jetë usulist dhe jurist, në mënyrë që t'i përdorë këto katër burime dhe të tjera burime si: El-Maslahatu el-mursiletu, El-Istihsan, shariatet e atyre që kanë qenë përpara nesh ... e të tjerë.

Nuk i lejohet asnjë njeriu të mbështetet vetëm te hadithi pa u kthyer te Kur'ani i madhërishtë, pa u kthyer te ajo që kanë thënë sahabet e ndëruar, Allahu qoftë i kënaqur prej tyre, për këtë hadith dhe si kanë vepruar me të. Libri më i mirë si pikë referimi për këtë gjë është libri: Musannef Ibn Ebi Shejbe, Musannef Abdurrezak dhe Sunen Seid ibn Mensur. Këto tre libra përmendin mendimet e sahabeve dhe tabiinëve rreth hadithit që transmetojnë për një temë të veçantë.

*intervistë e zhvilluar nga faqja e internetit: [www.alssunnah.com](http://www.alssunnah.com)*

Intervistoi: **Selman El-Hursh**

*Përktheu nga arabishtja: Lavdrim Hamja*

## MYFTIU PRITI AMBASADORIN E SHBA, Z. ALEXANDER A. ARVIZU



**D**itën e hënë, më 24 shkurt 2014, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, priti në një takim zyrtar, Ambasadorin e ShBA në Shqipëri, z. Alexander Arvizu.

Me rastin e kësaj vizite, Myftiu i Shkodrës ka shprehur kënaqësinë e tij për vizitën e Ambasadorit Arvizu, në Myftininë e Shkodrës, duke e konsideruar këtë si shenjë e respektit dhe vlerësimit që përfaqësuesi më i lartë i ShBA, në Shqipëri, ka për Myftininë Shkodër dhe aktivitetin e saj të larmishëm.

Nga ana e tij, ambasadori amerikan, ka vlerësuar angazhimet dhe shërbimet me përkushtim të Myftinisë Shkodër në drejtim të ruajtjes dhe kultivimit të vlerave të harmonisë, paqes dhe mirëkuptimit në mesin e njerëzve në Shkodër dhe përtej saj.

Në këtë kontekst, Myftiu i Shkodrës e ka vënë në dijeni z. Arvizu, se Shkodra, përtej historisë së saj, ka

ruajtur një emërues të përbashkët ndër shekuj; harmoninë dhe tolerancën ndërjetare, që është kthyer në një natyrë të jetuar në mesin e qytetarëve të Shkodrës. Myftiu ka konfirmuar gjithashtu se Myftinia Shkodër, është e angazhuar maksimalisht për t'u dëshmuar si mbrojtëse dhe kultivuese e denjë e mësimëve të harmonisë, të cilat burojnë nga Kur'ani dhe Traditat e Profetit Muhammed (a.s).

Myftiu i Shkodrës dhe Ambasadori i ShBA, kanë ndarë mendime dhe ide edhe rreth zhvillimit të jetës fetare në Shkodër, medreseve dhe larmisë së tyre, aktivitetit bamirës etj, për të cilat, Myftiu ka bërë një prezantim të detajuar, duke e informuar z. Arvizu për shërbimet cilësore, me të cilat Myftinia Shkodër përpiqet ta prezantojë Islamin, në gjurmët e të parëve dhe me vështrimin nga e ardhmja.

Dy bashkëbiseduesit kanë këmbyer edhe dhuratat simbolike me rastin e këtij takimi të shënuar.



"SA MË SHUMË  
QË LARTËSOHEMI  
DREJT QIELLIT,  
AQ MË TEPËR  
DO TË SHTOHET  
NUMRI I VOGËLSIRAVE  
NË SYTË TANË.  
SA MË SHUMË  
QË LARTËSOHEMI  
DREJT QIEJVE TË MORALIT,  
AQ MË TEPËR,  
GJËRAT QË DIKUR  
NA IRRITONIN,  
DO TË FSHIHEN  
NGA HARTA!"

(NGA GJUHA ARABE)

## MYFTIU URON AMBASADORIN AL-BADER ME RASTIN E DITËS SË PAVARËSISË SË KUVAJTIT



**M**brëmjen e së martës, më 25 shkurt 2014, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari ka marrë pjesë në pritjen, që Ambasada e Kuvajtit në Tiranë ka organizuar me rastin e ditës së Pavarësisë.

Me këtë rast, Myftiu ka uruar Ambasadorin e Kuvajtit, z. Najeeb Al-Bader, me rastin e kësaj dite të shënuar për popullin kuvajtian, duke uruar që ditë plot mirëqenie, besim, siguri e përparim të ketë për Shtetin e Kuvajtit dhe popullin e tij. Me këtë rast, Myftiu e ka falënderuar Ambasadorin Al-Bader për angazhimet e tij në drejtim të forcimit të marrëdhënieve vëllazërore në mesin e dy vendeve dhe kontributin në mbështetje të projekteve të ndryshme, në kuadër të bashkëpunimit me Myftininë Shkodër.

Gjatë kësaj mbrëmje festive, Myftiu është takuar edhe me Kryetarin e Bashkësisë Islame të Kosovës, Mr. Naim Tërnavë, me të cilin ka këmbyer urimet dhe lutjet më të përzemërta për mbarësi dhe sukses në punën dhe arritjet e ndërsjellta. Njëkohë-

sisht, ka këmbyer edhe urime të sinqerta me ish-Myftiun e Dibrës së Madhe, z. Ruzhdi Lata, sot Kryetar i Komunës Dibër, në Republikën e Maqedonisë.

Ambasada e Shtetit të Kuvajtit në Tiranë, është hapur në vitin 2011 dhe nga ajo ditë, Myftinia Shkodër ka krijuar një marrëdhënie të mirë bashkëpunimi për projekte të ndryshme në dobi të komunitetit.



"HUMBJA  
MË E MADHE  
PËR NJERIUN  
ËSHTË,  
NËSE NË XHENET,  
GJERËSIA E TË CILIT  
ËSHTË SA QIEJT  
DHE TOKA,  
NUK DO TË KETË  
VEND PËR TË!"

(NGA GJUHA ARABE)





Prof. dr. Njazi Kazazi  
USH "Luigj Gurakuqi"

### 1. Hyrje:

Veprën e thirrësit Islam, z. Muhamed Sytari, (Myfti i Zonës së Shkodrës) **"FAIK HOXHA - Para pasqyrës së një jete..."**, botim i LOGOS-A (Shkup, prill, 2011), ka disa kohë që e kam në dorë dhe vërtet jam i kënaqur për vlerat që ka ai libër.

Është i 14-ti libër që na jep z. Sytari, në një perudhë kohe nga viti 1998, kur ishte student në Damask, për të ardhur *"hap pas hapi"* në botime shumë serioze në vazhdim, për të arritur deri në monografi. Nuk kam ndër mend të zgjatëm më tepër në titujt e librave, por nuk mund të rri pa përmendur botimet për: *"Vehbi Sulejman Gavoçi - dijetar nga dijetarët e ymetit"*, (Monografi), Prishtinë, 2005; *"Kujtime dhe refleksione të një Ramazani"*, Shkodër, 2007; *"Bibliografi të 'Udhës Islame' në 50 numrat e parë"*, Shkodër, 2007 etj.. *"Rrugëtime të një hatibi"*, e dhjetra shkrime në gazeta të ndryshme, që auditori i nderuar tashmë i njeh dhe për të arritur tek vepra e fundit për Haxhi Faik Hoxhën. Fatmirësisht unë i kam të gjithë librat e Myftiut në bibliotekën time, me kushtime, dhe jam shumë i lumtur.

### 2. Vështrim për monografinë

Për të folur a shkruar për jetën e Myftiut të parë të Shkodrës, së përiudhës postkomuniste, autorit i është dashur të hapë *"dosarët"* e jetës së tij, e *"... për të parë në to se kush është në të vërtetë ky njeri që kaderi e solli të ishte Myfti i Shkodrës për 12 vite*

# NJË MONOGRAFI PËR HAXHI FAIK HOXHËN

(BOTIM ME VLERA SHKENCORE DHE FETARE)

*me radhë!"* (Muhamed Sytari, Faik Hoxha...fq. 7).

*"Çfarë kontributi ka dhënë ai në lëvizjen Islame të këtyre dy dekadave të fundit në Shkodër, por jo vetëm? E, në prehrin e 80 viteve jetë që mban mbi supe, si e ndjen veten përpara paqyrës së jetës? Një jetë, plot peripeci e ngjyra!? Një jetë plot vujtje, mundime, por edhe të papritura të këndshme..."* (Poaty, fq. 8).

Me këtë merret gjatë gjithë monografisë autori.

Z. Sytari tregon me hollësi për origjinën e Familjes së Faik Hoxhës, për babain e tij të nderuar, Hirësinë e Tij Sheh Qazim Hoxhën, Nënkyetar i Këshillit të Ulemave dhe për veprimtarinë e gjerë që ka ushtruar ai gjatë gjithë kohës. (Gjyshi i Haxhi Faikut, me origjinë nga Sudani ka qenë oficer turk me gradën kolonel, drejtor i spitalit ushtarak të Shkodrës). Për herë të parë H. e Tij Sheh Qazimi, ka studiuar në shkollën ushtarake të Shkodrës, të cilën e ka kryer me sukses. Vazhdoi studimet pranë Haxhi Muhamed Efendi Bektishi, prej të cilit mori i xhazetin (diplomen). Në vazhdim ka punuar si Imam në Xhaminë e Madhe të Medrezesë së Shkodrës dhe për 6 vite më radhë ka dhënë mësim fetare në këtë qytet. Në qershon të vitit 1925 e caktuan në Durrës, si Myderis e Vais duke dhënë edhe mësim fetare. Në vitin 1929 u emërua Myderris (profesor) i gjuhës arabe dhe i logjikës në Medresenë e Përgjithshme të Tiranës. Dallohet si mësues cilësor gjatë viteve që punoi aty, *"...por edhe si shërbyes fetar, kur xhamia mbushej plot me besimtarë dhe frekuentues që vinin për ta ndigju! Bënte vasë në xhami të ndryshme, si në xhaminë e Vjetër (që u dogji) në xhaminë e Et'hem Beut", ... etj. kujton Haxhi Faiku.*

Dhe pas ardhjes në Shkodër, më 1948, ku mban ligjërata në Xhaminë e Parrucës, në Xhaminë e Fushë-Çelës, në Xh. Begas dhe vazhdon shërbimin fetar. Kishte miqësi me shumë hoxhallarë të kohës, si: Hafiz Halil Tophana, (Myfti i Shkodrës, 1950-1958) dhe me Hafiz Sabri Bushatin (Myfti i Shkodrës në vitet, 1939-1945).


Sheh Qazimi ka pasur katër djem: Hysenin (që është nda nga kjo jetë më 1948, në moshën 20 vjeçare), Faikun, Hilminë dhe Mërzukun (për të cilin është një histori interesante, që shkruhet në libër, sipas një letërkembimi me Sheh Mërzukun e Marokut) që nuk po e tregoj, por jua lë që ta lexoni.

Këto edhe fakte të tjera do të gjeni brenda librit në fjalë, që autori i ka marrë gjatë interviteve në kohë të ndryshme nga Haxhi Faiku, që siç thotë vetë i duhej të hapte shumë *"dosarë"*. Një pune e lodhshme dhe e mundimshme, por ia ka arritur qëllimit për të na paraqitur portretin e njeriut të mirë në të gjithë pikëpjetet: si myfti, si prind dhe si qytetar.

Monografia është model i punës kërkimore-shkencore, sepse autori *"ka gërmuar"* me durim në dhjetra organe shtypi, si: *"Zani i Naltë"*, *"Kultura Islame"* për ardhur edhe në organet aktuale, si *"Drita Islame"* në Tiranë, *"Udha Islame"* në Shkodër etj. Dhe kjo duket qartë në referencat që ka përdorur autori të cilat janë me dhjetra (saktësisht 42 të tilla) pa përmendur ato ku u referohet arkivit të Myftinisë, që janë të panumërta.

Për jetën e veprën e famijes Hoxha kanë shkruar në periudha të ndryshme (pjesë të librave ose shkrime të plotë në organe të peridikut), intelektualë të Shkodrës dhe më gjerë:





si zotërinjtë Hamdi Bushati: (në librin “Shkodra dhe motet...”, Shkodër, 1998) Faik Luli (Haxhi Faik Hoxha “Qytetar Nderi” i Shkodrës, në librin: “Opinione për libra, ngjarje, një-rëz”, Shkup, 2004); Islam Dizdari, (“Haxhi Faik Hoxha, Mytiu i parë i Shkodrës pas shpalljes së demokracisë”, në gazetën “Drita Islame” viti XIX, nr. 4 (327), prill 2010, fq. 14); F. Luli, I. Dizdari, Nexhmi Bushati (në librin “Në kujtim të brezave”, Shkodër, 1997; Muhidin Ahmeti (“Mendimi fetar e filozofik në revistën “Zani i Naltë” në përmbledhjen e kumtesave “Zani i Naltë”, Shkodër, 1999); Nazim Bërdica (“Mësues, predikues dhe mistik i lartë” në gazetën “Drita Islame”, Viti I, Tiranë, gusht, 1992; Faik Zaganjori (“Haxhi Faik Hoxha, “Myfti Nderi i Shkodrës”, në 80 vjetorin e lindjes”, në “Udha Islame”, viti VIII, nr. 86, prill, 2010) etj.

Haxhi Faiku ka lindur në Shkodër më 14. 04. 1930 në lagjen Parrucë. Mësimet i filloi në “Shkollën e Kuqe” të Tiranës dhe i përfundoi më 1939. Mësimiet e para fetare i mori në shtëpi, nën kujdesin e babës së tij, Hirësisë së Tij Sheh Qazimit dhe të rrethit familjar që nxitën interesimin për arsimin fetar.

Vazhdoi mësimet në shkollën e mesme, në “Medresenë e Përgjithshme” në Tiranë, të cilën e përfu-

ndoi në vitin 1948 me rezultate të shkëlqyeshme. Këtë vit Sheh Qazimi dëbohet nga Tirana dhe e gjithë familja, me të edhe Haxhi Faiku vjen në Shkodër. Në vitin 1950 emërohet profesor në Medresenë e Përgjithshme në Tiranë, ku dha lëndët fetare dhe të përgjithshme. Në këtë detyrë i tregua i aftë, i dashur, u nderua nga nxënësit dhe u vlerësua nga eprorët. Në vitin 1954 kryen shërbimin ushtarak dhe menjëherë fillon punën në Kooperativën e Artizanatit të Shkodrës si llogaritar, detyrë që e vazhdoi deri në vitin 1966. (Kujtojmë se më 1959, kur ndërroi jetë Sheh Qazim Hoxha, me ixhazet të posaçëm ia lë djalit të tij, Faikut detyrën e kryesisë së tarikatit Tixhani).

*Më 1966 arrestohet dhe dënohet me 25 vjet burg për sabotim ekonomik dhe agjitacion e propagandë kundër pushtetit popullor! nga regjimi komunist. Doli nga burgu në vitin 1989. Kujtimet e tij për vitet e burgut janë të gjalla, plot të papritura dhe të ngjallin urrejtje. Haxhi Faiku tregon: “Në burg kam kaluar ditë të vështira, por besimi në Zotin (xh.sh.) më ka mbajtur të fortë dhe më ka bërë që të jem edhe predikues dhe këshillues edhe për shumë të burgosur të tjerë, gjë për të cilën ata e kanë dëshmuar edhe pas daljes nga burgu, në vitet e lirisë”. (M. Sytari, Faik Hoxha..., fq. 32).*

Ndryshimet shoqërore që ndodhen pas viteve '90 krijuan mundësi të reja për Haxhi Faikun. Ai u angazhua me të gjitha energjitë për rizgjimën e ndjenjave të qytetarëve në besimin te Zoti i madhërishëm dhe për hapjen e xhamive të reja në Shkodër. Në mbledhjen e parë të përfaqësuesve të rretheve në shkurt të vitit 1991, Haxhi Faiku u emërua Myfti i Shkodrës, ndërkohë ka kryer edhe detyrën e imamit dhe të vaizit në Xhamitë e Plumbit, Parrucës dhe Ebu Bekar (në Fushë Çelë). Institucioni i Myftinisë u ripërtri, funksionoi me të gjitha organizmat e veta, iu përshtat nevojave të kohës që për momentin ishin tepër të vështira. Kjo Myftini u bë krahu i djathtë i KMSH dhe qe

në ballë të të gjitha përpjekjeve për përhjën e Islamit.

Gjatë periudhës kur ishte Myfti Haxhi Faik Hoxha, u ndërtuan 9 xhami në qytet dhe 38 në fshatra, u vunë në funksionim ato kishin mbetur pa u shkatërruar nga diktatura komuniste. Në këto vite u hap medreseja “Haxhi Sheh Shamia”, në lagjen Dudas si dhe u ndërtuan dy godina madhështore: në lagjen Perash, dega e Vajzave aty ku ishte shtëpia e “Daut Boriçit”; e ajo e djemve në truallin e Xhamisë së Haxhi Bajramit.

U dallua për sigurimin e qetësisë, humanzimit, bashkimit të qytetarëve dhe tolerancës fetare. U tregua tolerant dhe bashkëpunoi vazhdimisht me komunitet fetare, atë katolik dhe ortodoks, me përfaqësuesit e këtyre komuniteteve: Arqipeshkëvinë dhe Famullinë Ortodokse të Shkodrës. Bashkëpunoi ngushtë me organet e pushtetit vendor me Bashkinë dhe Prefekturën.

Veprimtaria e Haxhi Faikut u ndërrua dhe u vlesësua nga institucionet shtetërore dhe fetare. Mes tyre është dhënia e titullit “Qytar Nderi” i Shkodrës dhe dekorata e lartë “Pishtar i Demokracisë” nga Presidenti i Republikës.

Tek Haxhi Faik Hoxha kemi parë njeriun e veprimit e të sakrificës, i cili me entuziazëm dhe pa përtesë, me besimin e madh të Zoti (xh. sh.) nuk ndjeu as moshën, as peshën e mundimit të viteve të burgjeve komuniste, por gjithnjë me cilesitë e një kleriku dhe intelektual të fomuar e të talentuar në misionin e Islamit, u tregua shembullor.

### 3. Përfundime

Dhamë shkurtimisht vlerat e monografisë së Muhamed Sytarit për Faik Hoxhën dhe “zbuluam” shumë pak nga monografia, për t’ua lënë lexuesve që do të marrin në dorë këtë libër të dobishëm, të këndshëm dhe plot vlera shkencore dhe fetare.

I urojmë autorit për librin dhe sukseset në botimet që do të vijin...

## "Mos u ndani nga Hatmeja Sherife dhe mësimi i Kur'anit"



**D**itën e xhuma, më 28 shkurt 2014, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari ka mbajtur hytben e xhumasë në xhaminë e fshatit Bardhej. Këtë javë, Myftiu zgjodhi të fliste rreth vlerës dhe rëndësisë që ka angazhimi i muslimanëve me Librin e All-llahut, Kur'anin.

Në mesazhin e tij para të pranishëmve, Myftiu tha se Kur'ani nuk duhet lënë pas dore, nuk duhet të mbetet si një libër i rëndomtë në raftet e bibliotekave, por duhet vlerësuar si Fjala e Zotit, me të cilën, Ai dëshiron të na udhëzojë e të na mbrojë përherë nga devijimi në besim, nga shthurja në jetë dhe njëkohësisht të na lartësojë në këtë botë dhe në tjetrën.

Myftiu ka shpjeguar sesi sot, në trupin e Islamit janë futur mendime dhe shpjegime të gabuara, që kanë për qëllim shkëputjen e marrëdhënies së muslimanëve me Librin e All-llahut. "Këtë po e shohim edhe nëpërmjet fetvave a mendimeve devijuese të disave që po ju thonë të mos mblidheni në tubimet e Kur'anit, të mos uleni për ta kënduar të plotë atë, të mos prezantoni mexhliet e dhikrit

e ato të salavatit etj. Por, unë po ju them se syneti i Muhammedit (a.s) është Hatmeja e Kur'anit, mexhliet e dhikrit me xhemat, tubimet për t'i kënduar dashnisë së All-llahut dhe Pejgamberit të Tij" – tha Myftiu.

Më pas, shpjegoi se: "Në hadithin e transmetuar nga Ibni Abbasi (r.a), një person e pyeti të Dërguarin e All-llahut, se cila ishte vepra më e pëlqyer tek All-llahu. Ai, ndër të tjera i tha: "... **Ta nisësh leximin e Kur'anit nga fillimi. Sa herë që ta përfundosh, ta nisësh sërish nga fillimi**"<sup>1</sup>, duke nxitur traditën e Hatmes Sherife (leximin e plotë të Kur'anit në mënyrë të vazhdueshme). Ndërsa në hadithin e transmetuar nga Enesi (r.a), Resulull-llahi lajmëroi se: "Me të vërtetë All-llahu ka të dashur e të përzgjedhur në mesin e njerëzve" E pyetën: Kush janë ata, o i dërguar i All-llahut? Ai tha: "**Njerëzit e Kur'anit, janë të dashurit e All-llahut dhe njerëzit e Tij të afërt!**"<sup>2</sup> Prandaj, unë ju ftoj të mos ndaheni nga Kur'ani, nga mexhliet e hatmes sherife dhe mësimi të tij nëpër xhami etj".

1. Transmetuar nga Imam Tirmidhiu.

2. Transmetuar nga Nesaiu, Ibni Maxheh dhe El-Hakim, sikurse edhe Imam Ahmed i në "El-Musned".



A e keni ditur se  
**Hafiz Abaz Golemi**  
**(1870-1925),**  
 ishte drejtori i parë  
 i shkollës së Parrucës,  
 që u hap në vitin 1913.  
 Këtë detyrë,  
 Hoxha i nderuar  
 e ushtroi për 12 vjet!



KLITHJET  
E "NJERËZVE TË RINJ",  
PËRVEÇSE NJË NDOTJE  
INTELEKTUALE  
DHE KAKOFONI PERVERSE,  
JANË NË VETËVETE  
NJË VËRTETUES I FORTË  
SE SI DEGRADON  
NJERIU PABESIMTAR  
NË GRADËT MË TË ULËTA  
TË QËNIES NJERËZORE...

## FADIL ELEZ KRAJA, "MIRËNJOHJE" PËR PUNËN E IMAMIT 80 VJEÇAR

**D**itën e hënë, më 3 mars 2014, Myftinia Shkodër ka organizuar një koktjel, me rastin e vlerësimit me "Mirënjohje" të punës dhe kontributit mbi 20 vjeçar në shërbim të KMSH dhe Myftinisë Shkodër, të imamit të nderuar, z. Fadil Elez Kraja, në atmosferën e 80 vjetorit të tij.

Me këtë rast, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, ka vlerësuar kontributin dhe shërbimet e shumta të z. Fadil E. Kraja, në mbi 20 vite, në të cilat ka shërbyer në shumë detyra dhe vende, si: Myfti i Lezhës, imam në disa zona të Shkodrës dhe mësues i mësim-besimit, ku përherë është interesuar të kryejë me përkushtim detyrën e ngarkuar.

Myftiu ka theksuar se është obligim të shprehim falënderimet dhe mirënjohjen tonë ndaj atyre që na mësojnë fenë, që kontribuojnë për të dhe kthehen në shembuj udhëzimi dhe orientimi për më të rinjtë.

Më pas, Myftiu i ka akorduar z. Fadil E. Kraja, "Mirënjohje", nëpërmjet së cilës, Myftinia Shkodër: *"shpreh vlerësimin dhe mirënjohjen e saj për punën e palodhshme, angazhimin kor-*

*rekt dhe vullnetin e lartë të dëshmuar në periudhën 1991 - 2014 në shërbim të Myftinisë Shkodër, si imam, vaiz, mësues mësim-besimi"*.

Me shumë emocion, z. Fadil E. Kraja, ka falënderuar Myftininë Shkodër për këtë vlerësim, si dhe ka ndarë emocione dhe kujtime me të ftuarit, duke theksuar se shërbimet e deritanishme kanë qenë shprehje e gatishmërisë së tij për të shërbyer në dobi të mësimëve dhe mesazheve islame kudo, ku komuniteti ka patur nevojë. Njëkohësisht, nuk i ka fshehur emocionet e tij, i rrethuar në mesin e shokëve të hershëm dhe miqve të mirë.

Vlerësime dhe kujtime të bukura, plot emocione, nga shërbimet dhe miqësia me z. Fadil E. Kraja, si imam e mësues, kanë dhënë edhe H. Fejzi Zaganjori, z. Kujtim Dervishi, z. Arben Halluni, H. Bashkim Bajraktari, teologu Lavdrim Hamja, z. Bujar Ballaj, z. Hajrullah Jakupi, H. Kujtim Cufaj, teologu Naim Drijaj, z. Ferit Hafizi, z. Ismet Alushi dhe teologu Ervil Kuçi.

Kjo ceremoni vëllazërore është mbajtur me një lutje të përbashkët.



# NË DUART TUAJA TRE LIBRA TË RINJ NGA THIRRËSI ISLAM LAVDRIM HAMJA



**Botues:**  
Myftinia Shkodër  
**Drejtues:**  
Imam Muhamed Sytari

**Dizajn & Grafik:**  
Bledar Xama

**Tel / Fax:**  
+355 (0) 224 2081  
**Nr. llogarie:**  
100054 UBA - Shkodër

**E-mail:**  
udhaislame@myftinia-shkoder.org  
**Website:**  
www.myftinia-shkoder.org